



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-126**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-099 PËR  
LETËRNJOFTIMIN**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-099  
PËR LETËRNJOFTIMIN**

**Neni 1**

1. Neni 2 i ligjit bazik, përkufizimi **“Letërnjoftim”** ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

**“Letërnjoftim”** - nënkupton dokumentin publik që përmban të dhënat personale në formë fizike dhe elektronike, që ruhen në çip dhe i cili i lëshohet shtetasit të Republikës së Kosovës për të vërtetuar identitetin dhe shtetësinë e bartësit të dokumentit.

2. Neni 2 i ligjit bazik, përkufizimi **“Letërnjoftimi për të huajt”** ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

**“Letërnjoftimi (lejeqëndrimi) për të huajt”** - nënkupton dokumentin publik që përmban të dhënat personale në formë fizike dhe elektronike, që ruhen në çip dhe iu

lëshohet shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, të cilët e kanë të rregulluar qëndrimin në Republikën e Kosovës sipas ligjeve përkatëse në fuqi.

3. Neni 2 i ligjit bazik, përkufizimi **“Qytetar”** ndryshohet dhe riformulohet si në vijim.

**“Shtetas i Kosovës”** - nënkupton personin i cili e ka shtetësinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Shtetësinë.

4. Neni 2 i ligjit bazik, përkufizimi **“Ditët”** fshihet nga teksti i ligjit.

5. Neni 2 i ligjit bazik, pas përkufizimit **“Qëndrimi i përhershëm”** shtohet përkufizimi i ri **“Çip”** me tekstin si vijon:

**“Çip”** - nënkupton pajisje elektronike e vendosur në letërnjoftim, në të cilën në formë elektronike janë të vendosura të dhënat e bartësit të letërnjoftimit.

## Neni 2

Neni 4 i ligjit bazik, paragrafi 4.2. riformulohet si vijon:

4.2. Shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, të cilët qëndrojnë në Republikën e Kosovës, letërnjoftimet iu jepen në bazë të ligjeve përkatëse në fuqi.

## Neni 3

1. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 8.2. riformulohet si vijon:

8.2. Letërnjoftimi përmban:

- a). stemën e Republikës së Kosovës;
- b). emrin e shtetit;
- c). emrin e dokumentit;
- d). mbiemrin;
- e). emrin;
- f). shtetësia;

- g). gjininë;
- h). datën e lindjes;
- i). vendin e lindjes;
- j). datën e skadimit;
- k). fotografinë;
- l). datën e lëshimit;
- m). organin që e lëshon;
- n). numrin personal;
- o). numrin e qendrës komunale të regjistrimit;
- p). numrin e letërnjoftimit;
- q). vendbanimin;
- r). nënshkrimin e aplikuesit;
- s). hapësirën për leximin elektronik të të dhënave.

2. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 8.3. riformulohet si vijon:

8.3. Letërnjoftimi përmban çipin elektronik, në të cilin përveç të dhënave nga neni 8, paragrafi 8.2, janë të ruajtura edhe pamja e fytyrës, gjurmët e gishtërinjve dhe adresa e vendbanimit.

3. Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 8.7. riformulohet si vijon:

8.7. Formularët për letërnjoftim dhe letërnjoftimi, prodhohen nga personi juridik i autorizuar nga ministria.

#### **Neni 4**

Neni 9 i ligjit bazik, riformulohet si vijon:

Formularët dhe letërnjoftimet shtypen në gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve.

### **Neni 5**

Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 13.1. afati prej **“tridhjetë (30)”** ditëve zëvendësohet me afatin prej **“pesëmbëdhjetë (15)”** ditëve.

### **Neni 6**

Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 15.2. riformulohet si vijon:

15.2. Shtetasit më të rinj se tetëmbëdhjetë (18) vjet, si dhe shtetasit që nuk kanë zotësi veprimi, duhet që në momentin e aplikimit të jenë të shoqëruar nga përfaqësuesi ligjor.

### **Neni 7**

1. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 16.2. pika d) **“vendqëndrimin”** fshihet nga teksti i ligjit.

2. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 16.7. afati prej **“tridhjetë (30)”** ditëve zëvendësohet me afatin prej **“nëntëdhjetë (90)”** ditëve.

### **Neni 8**

Neni 19 i ligjit bazik riformulohet si vijon:

Institucionet shtetërore varësisht nga autorizimi i përcaktuar me ligj, mund t’i përdorin të dhënat nga evidenca për letërnjoftimet e lëshuara në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## **Neni 9**

Neni 21 i ligjit bazik, paragrafi 21.1. pjesa e parë e paragrafit riformulohet si vijon:

21.1. Me gjobë prej njëzetepesë (25) deri në njëqind (100) Euro, dënohet për kundërvajtje shtetasi:

## **Neni 10**

Neni 23 i ligjit bazik riformulohet si vijon:

Të gjitha të hyrat që realizohen me zbatimin e këtij ligji derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Neni 11**

Neni 25 i ligjit bazik riformulohet si vijon:

Letërnjoftimet e Republikës së Kosovës përdoren deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

## **Neni 12** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-126**  
**30 gusht 2012**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**